



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë - Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail.. contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të miratuar me datën 08.12.2021 nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. - Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 17.12.2021, **SHPALLË:**

KONKURSIN PUBLIK

I. Titulli i vendit të punës: Punëtor fizik në Departamentin Teknik - një (1) vend pune;

II. Numri i referencës: NPL -D.M. 17/12/2021;

III. Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët fizike, brenda dhe jashtë objektit.
- Bënë bartjen e panove për programe të ndryshme në objekt dhe në qytet,
- Sjelljen dhe largimin e sendeve të ndryshme dhe të inventarit, brenda dhe jashtë objektit,
- Bartjen, montimin dhe demontimin e ringut, tribunave, skelave të ndryshme hedhjen e mbeturinave,
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta në objekt dhe në të gjitha sipërfaqet tjera, pastrimin e mureve, karrigeve, tavolinave dhe enterierit tjetër,
 - pastrimin e zyrave të administratës,
- Mirëmban pastërtinë e dyshemesë, tepihëve, larjen e dritareve, perdeve e tjera,
- Bënë pastrimin me mjete teknike të gjitha sipërfaqeve që mund të pastrohen në objekt, me makinë thithëse,
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së përgjegjësit për higjienë dhe kryepunëtorit.

IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit

- Kërkesa për punësim (aplikacioni); Dëshmi për shkollimin e noterizuar; përvoja e punës e vërtetuar me këto dokumente të protokolluara nga punëdhënësit ku ka punuar: vërtetimi nga punëdhënësit, kontrata e punës nga punëdhënësit ku ka punuar, si dhe referenca e punës nga punëdhënësit, kopja e trustit pensional, Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera; Kopja e letërnjoftimit; Certifikata e lindjes; Adresa e vendbanimit; Nr. i telefonit kontaktues si dhe E-maili kontaktues;

V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës

Kualifikimi fillor.
Përvoja një vjeçare

VI. Kohëzgjatja e emërimit:

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

VII. Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data 17.12.2021.

VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:

- Aplikacionet për punësim mund të merren në ueb faqën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë si dhe fizikisht në zyrën e Departamentit të Administratës dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.